Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

# ANALIZA E TREGUT PËR KULTURA PEMËTARE

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE

# Analiza e tregut për kultura pemëtare

## 2019-2021

Dhjetor, 2022

# Tabela e përmbajtjes

**Lista e tabelave** ..... **3**
**Lista e figurave** ..... **4**
**Lista e shkurtesave** ..... **6**
**Hyrje** ..... **7**
**Metodologjia** ..... **8**
**Përmbledhje** ..... **9**
**1 Prodhimtaria e sektorit të pemëve** ..... **11**
1.1 Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i pemëve ..... 11
1.2 Kulturat pemëtare më të kultivuara ..... 13
1.2.1 Molla ..... 14
1.2.2 Kumbulla ..... 14
1.2.3 Mjedra ..... 15
1.2.4 Arra ..... 15
1.2.5 Dardha ..... 16
**2 Tregtia për sektorin e pemëve** ..... **17**
2.1 Eksporti dhe importi i kulturave pemëtare ..... 18
2.1.1 Eksporti dhe importi i mollës ..... 21
2.1.2 Eksporti dhe importi i kumbullës ..... 25
2.1.3 Eksporti dhe importi i mjedrës ..... 28
2.1.4 Eksporti dhe importi i arrës ..... 32
2.1.5 Eksporti dhe importi i dardhës ..... 35
**3 Çmimet e kulturave pemëtare** ..... **39**
3.1 Çmimet për kulturën e mollës ..... 40
3.2 Çmimet për kulturën e kumbullës ..... 40
3.3 Çmimet për kulturën e mjedrës ..... 41
3.4 Çmimet për kulturën e arrës ..... 41
3.5 Çmimet për kulturën e dardhës ..... 42
**4 Mbështetja direkte për sektorin e pemëve** ..... **43**
4.1 Pagesat direkte për mollë ..... 45
4.2 Pagesat direkte për kumbull ..... 46
4.3 Pagesat direkte për mjedër ..... 47
4.4 Pagesat direkte për arrë ..... 48
4.5 Pagesat direkte për dardhë ..... 49
**5 Plotësimi i nevojave vendore dhe konsumi** ..... **50**
5.1 Plotësimi i nevoja vendore me kultura pemëtare ..... 50
5.1.1 Plotësimi i nevojave vendore për kulturat pemëtare më të kultivuara ..... 51
5.2 Konsumi për kokë banori ..... 54
**Konkluzionet** ..... **55**
**Shtojca** ..... **56**

# Lista e tabelave


Tabela 1: Sipërfaqja e kulturave pemëtare 2019-2021, në ha ....11
Tabela 2: Prodhimi i kulturave pemëtare 2019-2021, në tonë ....12
Tabela 3: Rendimenti i kulturave pemëtare 2019-2021, në tonë/ha ....13
Tabela 4: Eksporti dhe importi për pemë (kodin doganor 08) ....17
Tabela 5: Eksporti i kulturave pemëtare ....19
Tabela 6: Importi i kulturave pemëtare....20
Tabela 7: Eksporti dhe importi i mollës ....21
Tabela 8: Eksporti i mollës sipas muajve, në '000 € ....22
Tabela 9: Eksporti dhe importi i kumbullës ....25
Tabela 10: Eksporti dhe importi i mjedrës ....28
Tabela 11: Eksporti dhe importi i arrës ....32
Tabela 12: Eksporti dhe importi i dardhës....35
Tabela 13: Çmimet e kulturave pemëtare 2019-2021 ....39
Tabela 14: Pagesat direkte për sektorin e pemëve 2019-2021 ....43
Tabela 15: Pagesa direkte për mollë, 2019-2021 ....45
Tabela 16: Pagesa direkte për kumbull, 2019-2021 ....46
Tabela 17: Pagesa direkte për mjedër, 2019-2021 ....47
Tabela 18: Pagesa direkte për arrë, 2019-2021 ....48
Tabela 19: Pagesa direkte për dardhë, 2019-2021....49
Tabela 20: Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë tek kapitulli i tregtisë ....56

# Lista e figurave


Figura 1: Pjesëmarrja e kulturave pemëtare në gjithsej sipërfaqen e kultivuar me pemë ....13
Figura 2: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i mollës ....14
Figura 3: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kumbullës ....14
Figura 4: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i mjedrës ....15
Figura 5: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i arrës ....15
Figura 6: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i dardhës ....16
Figura 7: Pjesëmarrja e vlerës së importit dhe eksportit të pemëve (kodi doganor 08) në vlerën e importit dhe eksportit të produkteve bujqësore (kodet doganore 01-24) ....17
Figura 8: Eksporti, importi dhe bilanci tregtar për pemë (kodi doganor 08), në '000 € ....18
Figura 9: Vlera e eksportit të kulturave pemëtare, në % ....19
Figura 10: Vlera e importit të kulturave pemëtare, në % ....21
Figura 11: Eksporti i mollës 2019-2021 ....22
Figura 12: Eksporti i mollës sipas shteteve ....23
Figura 13: Importi i mollës 2019-2021 ....23
Figura 14: Importi i mollës sipas muajve, në '000 € ....24
Figura 15: Importi i mollës sipas shteteve ....24
Figura 16: Eksporti i kumbullës 2019-2021 ....25
Figura 17: Eksporti i kumbullës sipas muajve, në '000 € ....26
Figura 18: Eksporti i kumbullës sipas shteteve ....26
Figura 19: Importi i kumbullës 2019-2021 ....27
Figura 20: Importi i kumbullës sipas muajve, në '000 € ....27
Figura 21: Importi i kumbullës sipas shteteve ....28
Figura 22: Eksporti i mjedrës 2019-2021 ....29
Figura 23: Eksporti i mjedrës sipas muajve, në '000 € ....29
Figura 24: Eksporti i mjedrës sipas shteteve ....30
Figura 25: Importi i mjedrës 2019-2021 ....30
Figura 26: Importi i mjedrës sipas muajve, në '000 € ....31
Figura 27: Importi i mjedrës sipas shteteve ....31
Figura 28: Eksporti i arrës 2019-2021 ....32
Figura 29: Eksporti i arrës sipas muajve, në '000 € ....33
Figura 30: Eksporti i arrës sipas shteteve ....33
Figura 31: Importi i arrës 2019-2021 ....34
Figura 32: Importi i arrës sipas muajve, në '000 € ....34
Figura 33: Importi i arrës sipas shteteve ....35
Figura 34: Eksporti i dardhës 2020-2021 ....36
Figura 35: Eksporti i dardhës sipas muajve, në '000 € ....36
Figura 36: Eksporti i dardhës sipas shteteve ....37
Figura 37: Importi i dardhës 2019-2021 ....37
Figura 38: Importi i dardhës sipas muajve, në '000 € ....38
Figura 39: Importi i dardhës sipas shteteve ....38

Figura 40: Çmimet për mollë, 2019-2021 ..... 40
Figura 41: Çmimet për kumbull, 2019-2021 ..... 40
Figura 42: Çmimet për mjedër, 2019-2021 ..... 41
Figura 43: Çmimet për arrë, 2019-2021 ..... 41
Figura 44: Çmimet për dardhës, 2019-2021 ..... 42
Figura 45: Pjesëmarrja e kulturave pemëtarë në gjithsej pagesat direkte për sektorin e pemëtarisë ..... 44
Figura 46: Shpërndarja e pagesave direkte sipas kulturave pemëtarë (%) ..... 44
Figura 47: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për mollë ..... 45
Figura 48: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për kumbull ..... 46
Figura 49: Sasia e subvencionuar dhe shuma e paguar për mjedër ..... 47
Figura 50: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për arrë ..... 48
Figura 51: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për dardhë ..... 49
Figura 52: Furnizimi me kultura pemëtare, 2019-2021 ..... 50
Figura 53: Furnizimi me mollë, 2019-2021 ..... 51
Figura 54: Furnizimi me kumbull, 2019-2021 ..... 51
Figura 55: Furnizimi me mjedër, 2019-2021 ..... 52
Figura 56: Furnizimi me arrë, 2019-2021 ..... 52
Figura 57: Furnizimi me dardhë, 2019-2021 ..... 53
Figura 58: Konsumi i pemëve për kokë banori, 2019-2021 ..... 54

# Lista e shkurtesave

| | |
|---|---|
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| AZhB | Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë |
| DAESB | Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore |
| MBPZhR | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| OE | Operator Ekonomik |
| PPD | Programi i Pagesave Direkte |
| PRE | Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike |
| ShBA | Shtetet e Bashkuara të Amerikës |

# Hyrje

Pasqyrimi i gjendjes së një sektori të caktuar, përmes të dhënave të përmbledhura statistikore, është e një rëndësie të veçantë si në aspektin e krijimit të një baze mbështetëse në hartimin e politikave, ashtu edhe në pasqyrimin e progresit apo zhvillimit të një sektori të caktuar.

Duke qenë së në Kosovë sektori i pemëtarisë mbështetet si përmes pagesave direkte/subvencioneve ashtu edhe përmes granteve investive, është e rëndësishme të analizohet komplet tregu i produkteve pemëtare dhe zhvillimet e ndodhura në mënyrë të vazhdueshme që të shihet edhe efekti i këtyre politikave mbështetëse, por edhe të pasqyrohet nevoja e tanishme për mbështetjen e kulturave të caktuara dhe hallkave të caktuara të zingjirit të furnizimit.

Kjo analizë është përgatitur për të identifikuar ndryshimet në nivelet e prodhimit në sektorin e pemëve, si dhe në shpërndarjen dhe sipërfaqen e pemishteve, gjatë periudhës së fundit tre vjeçare, por të ndërlidhura këto edhe me raportin që ka Kosova me vendet e tjera në aspektin e tregtisë së kulturave pemëtare, se sa është e varur nga importi dhe si qëndron në aspektin e plotësimit të nevojave vendore për konsum.

Përmes kësaj analize dhe këtyre të dhënave të përmbledhura, jepet një pasqyrë për sektorin e pemëtarisë (me fokus në 5 kultura pemëtare më të kultivuara), duke përfshirë prodhimtarinë vendore, eksportin dhe importin, çmimet, mbështetjen direkte si dhe shkallën e plotësimit të nevojave vendore dhe konsumin për kokë banori.

# Metodologjia

Qëllimi i këtij publikimi është që në mënyrë të përmbledhur përmes të dhënave statistikore të paraqiten zhvillimet në sektorin e pemëtarisë në periudhën '19-'21, me fokus të veçantë në 5 kulturat pemëtare që kultivohen më së shumti në Kosovë.

Burimet e të dhënave të përdorura në këtë analizë janë: të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (të dhënat për sipërfaqen, prodhimin dhe rendimentin e kulturave pemëtare, të dhënat për numrin e popullsisë, si dhe të dhënat për tregtinë e jashtme që burim primar është Dogana e Kosovës), të dhënat nga DAESB lidhur me çmimet e kulturave bujqësore (të cilat DAESB i siguron përmes angazhimit të një OE që bën mbledhjen e këtyre të dhënave) dhe të dhënat nga AZhB (të dhënat për pagesa direkte). Të gjitha këto të dhëna janë përpunuar dhe janë bërë kalkulime nga DAESB. Analiza përmban 5 kapituj kryesor me nënkapituj përkatës. Më poshtë janë detajet se çka përmban secili kapitull i kësaj analize:

**Kapitulli 1: Prodhimtaria e sektorit të pemëve.** Në këtë kapitull janë të paraqitura të dhënat lidhur me sipërfaqen, prodhimin dhe rendimentin e kulturave pemëtare ku analizohet pjesëmarrja e tyre si dhe ndryshim i ndodhur mes viteve, ku vëmendje e veçantë i është kushtuar 5 kulturave pemëtare që kultivohen në sipërfaqe më të madhe në Kosovë.

**Kapitulli 2: Tregtia për sektorin e pemëve.** Në këtë kapitull janë të paraqitura të dhënat lidhur me tregtinë e jashtme të kulturave pemëtare, ku analizohet eksporti dhe importi si total, sipas muajve dhe sipas shteteve ku vëmendje e veçantë i është kushtuar 5 kulturave pemëtare që kultivohen në sipërfaqe më të madhe në Kosovë.

**Kapitulli 3: Çmimet e kulturave pemëtare.** Në këtë kapitull janë të paraqitura çmimet për 5 kulturat pemëtare më të kultivuara në Kosovë në nivel të fermës, në nivel të shitjes me shumicë dhe shitjes me pakicë.

**Kapitulli 4: Mbështetja direkte për sektorin e pemëtarisë.** Në këtë kapitull janë të paraqitura të dhënat e pagesave direkte/subvencioneve për sektorin e pemëtarisë, duke përfshirë mbështetjen direkte për hektarë të kultivuar për prodhim (në rastin e mjedrës), për sipërfaqe me kultura pemëtare organike si dhe për inpute (fidanë të pemëve drufrutore). Këtu është analizuar numri i aplikuesve, numri i përfituesve, numri i njësive të subvencionuara, pagesa për njësi të subvencionuar si dhe gjithsej shuma e subvencionimit.

**Kapitulli 5: Plotësimi i nevojave vendore dhe konsumi.** Në këtë kapitull bëhet një ndërlidhje e të gjitha të dhënave në kapitujt paraprak për të pasqyruar furnizimin me kultura pemëtare, duke përfshirë prodhimin vendor, importin dhe eksportin për të pasqyruar shkallën e plotësimit të nevojave për konsum me prodhim vendor si dhe konsumin për kokë banori.

Analiza përfundon me konkluzione ku në bazë të analizës së të dhënave paraqiten konkluzionet lidhur me 5 kulturat pemëtare më të kultivuara në Kosovë.

# Përmbledhje

Në Kosovë janë të kultivuara gjithsej 10,385 ha me pemë, nga të cilat janë prodhuar gjithsej 67,533 tonë. Sipërfaqja me pemë në periudhën '19-'21, shënoi rritje të vazhdueshme por që kjo rritje nuk u përcjell edhe tek prodhimi, i cili në vitin 2020 kishte rritje e pastaj u pasua me ulje, si rezultat i uljes së rendimentit tek të gjitha kulturat pemëtare. Janë 5 kultura pemëtare (molla, kumbulla, mjedra, arra dhe dardha), që përbëjnë 86% të gjithsej sipërfaqes me pemë dhe 91% të gjithsej prodhimit të pemëve.

Për të përmbushur nevojat vendore për konsum, Kosova vazhdon të importoj kultura pemëtare por edhe eksporton disa prej tyre por në sasi më të vogël, duke rezultuar kështu me një bilanc tregtar negativ në sektorin e pemëve. Kulturat pemëtare më të eksportuara (57% të gjithsej vlerës së eksportit), në vitin 2021 ishin: mjedra, manaferra, dredhëza, molla dhe qershia, pasuar nga të gjitha kulturat e tjera me pjesëmarrje 43%.

Prej gjithsej importit të pemëve në vitin 2021: 65.5% është import i disa prej kulturave kryesore që nuk kultivohen në vendin tonë si: banane, portokall, mandarinë, limon, hurma kivi, fik, ananas, avokado dhe grejpfrut, 24% (molla, dardha, nektarina, dredhëza, arra, pjeshka dhe ftoi), dhe pjesa tjetër prej 10.2% është import i kulturave tjera.

Importi i kulturave që më së shumti kultivohen në Kosovë (molla, kumbulla, mjedra, arra dhe dardha), përbënë vetëm 18% të gjithsej importit të pemëve, ndërsa në aspektin e eksportit këto kultura përbëjnë 29% të gjithsej vlerës së eksportit të pemëve. Nga 5 kulturat që kultivohen në sipërfaqe më të madhe në Kosovë, mjedra ka bilanc tregtar pozitiv dhe prodhimi vendor tejkalon nevojat vendore për konsum. Kumbulla dhe arra kanë bilanc negativ por plotësimi i nevojave vendore për konsum është mbi 90%, ndërsa molla dhe dardha importohen në sasi më të madhe për të arrit plotësimin e nevojave për konsum.

Eksport të kulturave pemëtare kryesisht ka në periudhën e vjeljes, duke qenë se vendi ynë ka kapacitete të kufizuara të ruatjes dhe një pjesë shumë e madhe e prodhimit shitet ose eksportohen menjëherë pas vjeljes. Si rezultat i mungesës se kapaciteteve të ruajtjes për periudhë më të gjatë kohore, importi është kryesisht më i lartë në periudhën kur nuk është koha e vjeljes së kulturave pemëtare, dhe me i ulët kur në dispozicion është prodhimi vendor.

Viti 2021 në krahasim me vitin paraprak u karakterizua me ngritje të çmimeve të kulturave pemëtare më të kultivuara në Kosovë. Rritje të çmimeve pati duke filluar nga çmimet e fermës e që u përcollën me rritje, pastaj edhe në nivelet e tjera si në atë me shumicë ashtu edhe me pakicë. Nga këto 5 kultura pemëtare, ngritje më të madhe të çmimit të fermës kishte mjedra për 102%, ndërsa ngritjen më të ulët e shënoi arra për vetëm 3%.

Kulturat pemëtare mbështeten përmes pagesave direkte, kryesisht për hektar të kultivuar me përjashtim të mjedrës e cila mbështetet për kg. Gjithashtu jepen subvencione edhe për pemishtet që janë të kultivuara si organike dhe fermerët përfitojnë pagesë më të madhe për

njësi sesa për pemishtet që nuk janë organike. Sa i përket inputeve përmes pagesave direkte mbështetet prodhimtaria e fidanëve të pemëve drufrutore.

Në periudhën 2019-2021, pjesëmarrja mesatare e pagesave direkte për sektorin e pemëtarisë (përfshirë pagesat për sipërfaqe, për prodhim të mjedrës, për sipërfaqe me pemishte organike dhe për fidanë të pemëve drufrutore), ishte 6.1%. Gjithsej pagesat për sektorin e pemëtarisë në vitin 2021 ishin 1.99 mil. €, dhe kulturat pemëtare që kanë pjesëmarrje më të madhe janë: molla, arra, kumbulla dhe lajthia, ndërsa kulturat e tjera kanë pjesëmarrje më të ulët.

Numri i fermerëve përfitues në vitin 2021, në shumicën e rasteve është më i vogël sepse ishin kriteret në PPD që u ndryshuan në krahasim me vitet paraprake, ku për të dëshmuar pronësinë e tokës së punuar e për të cilën është aplikuar për subvencionim, u kërkua që të dëshmohet trashëgimia në rastet kur toka nuk ishte në emër të aplikuesit.

Nga 5 kulturat më të kultivuara në Kosovë, rritje të njësive të subvencionuara shënuan arra dhe dardha, ndërsa molla, kumbulla dhe mjedra shënuar rënie në numrin e njësive të subvencionuara.

Kosova është vend neto importues i prodhimeve bujqësore dhe nevoja për të importuar produkte nga vendet e tjera vjen nga ajo se Kosova nuk arrin të plotëson nevojat konsumuese të popullsisë me prodhim vendor. Plotësimi i nevojave vendore për konsum me kultura pemëtare është në shkallën rreth 50%, përqindje e cila ndryshon varësisht prej kulturës. Nga 5 kulturat pemëtare që kultivohen më shumë në Kosovë, prodhimi i mjedrës tejkalon nevojat për konsum, kumbulla dhe arra plotësojnë mbi 90% të nevojave për konsum, ndërsa molla dhe dardha karakterizohen me përqindje më të ulët të plotësimit të nevojave për konsum.

# 1 Prodhimtaria e sektorit të pemëve

## 1.1 Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i pemëve

Në Kosovë në vitin 2021 gjithsej sipërfaqe me pemë ishin 10,382 ha, që në krahasim me vitin paraprak sipërfaqja shënoi rritje për 1.1%. Në përgjithësi, sipërfaqja e të gjitha kulturave pemëtare shënoi rritje me përjashtim të kategorisë pemë të tjera ku sipërfaqja u zvogëlua për 6.2%, në krahasim me vitin 2020. Kulturat pemëtare të cilat shënuan rritje në sipërfaqe mbi 5%, në krahasim me vitin paraprak ishin: boronica, kajsia dhe pjeshka, ndërsa kulturat e tjera shënuar rritje e cila varioi nga 0.3% deri në 4.4%.

Sa i përket pjesëmarrjes së kulturave pemëtare në gjithsej sipërfaqen me pemë, 86% e sipërfaqes mbulohet nga vetëm 5 kultura pemëtare si: molla, kumbulla, mjedra, arra dhe dardha, ndërsa pjesa tjetër prej 14% është e kultivuar me kultura të tjera pemëtare.

**Tabela 1: Sipërfaqja e kulturave pemëtare 2019-2021, në ha**

| Kultura[1] | 2019 | 2020 | 2021 | Pjesëmarrja në % (2021) | Ndryshimi 2021/2020 në % |
|---|---|---|---|---|---|
| Molla | 3,006 | 3,068 | 3,083 | 29.7 | 0.5 |
| Kumbulla | 2,096 | 2,201 | 2,210 | 21.3 | 0.4 |
| Mjedra | 1,637 | 1,661 | 1,665 | 16.0 | 0.3 |
| Arra | 886 | 1,295 | 1,352 | 13.0 | 4.4 |
| Dardha | 610 | 614 | 618 | 6.0 | 0.7 |
| Lajthia | 252 | 390 | 391 | 3.8 | 0.3 |
| Vishnja | 232 | 233 | 240 | 2.3 | 3.0 |
| Dredhëza | 235 | 236 | 238 | 2.3 | 1.0 |
| Qershia | 107 | 108 | 110 | 1.1 | 2.0 |
| Aronia | 88 | 98 | 98 | 0.9 | 0.4 |
| Boronica | 57 | 86 | 93 | 0.9 | 8.3 |
| Ftoi | 90 | 91 | 93 | 0.9 | 2.6 |
| Mushmolla | 51 | 51 | 53 | 0.5 | 4.0 |
| Pjeshka | 47 | 48 | 51 | 0.5 | 5.5 |
| Manaferra | 30 | 31 | 32 | 0.3 | 3.9 |
| Kajsia | 22 | 22 | 24 | 0.2 | 5.9 |
| Pemë të tjera | 31 | 32 | 30 | 0.3 | -6.2 |
| **Gjithsej sipërfaqja me pemë** | **9,479** | **10,265** | **10,382** | **100.0** | **1.1** |

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21)

[1] Renditja e kulturave është bërë në bazë të sipërfaqes së kultivuar në vitin 2021.

Nga sipërfaqja prej 10,382 ha, në vitin 2021 janë prodhuar gjithsej 67,533 tonë me pemë, ku prodhimi i pemëve është zvogëluar për 6.5%, në krahasim me vitin 2020. Kjo ulje e gjithsej prodhimit ka ardhur si rezultat i uljes së rendimentit tek të gjitha kulturat pemëtare, përkundër asaj se ka pasur rritje në sipërfaqe.

Përderisa nëse shikohet sipërfaqja e kultivuar, 5 kultura pemëtare përbëjnë 86% të gjithsej sipërfaqes, sa i përket prodhimit këto 5 kultura (molla, kumbulla, mjedra, arra dhe dardha) përbëjnë 91% të prodhimit të pemëve në Kosovë.

**Tabela 2: Prodhimi i kulturave pemëtare 2019-2021, në tonë**

| Kultura | 2019 | 2020 | 2021 | Pjesëmarrja në % (2021) | Ndryshimi 2021/2020 në % |
|---|---|---|---|---|---|
| Molla | 33,835 | 38,049 | 37,381 | 55.4 | -1.8 |
| Kumbulla | 12,745 | 13,147 | 11,247 | 16.7 | -14.5 |
| Mjedra | 7,206 | 6,659 | 5,840 | 8.6 | -12.3 |
| Arra | 2,028 | 2,591 | 2,108 | 3.1 | -18.6 |
| Dardha | 5,110 | 5,586 | 4,953 | 7.3 | -11.3 |
| Lajthia | 80 | 116 | 101 | 0.1 | -12.7 |
| Vishnja | 777 | 740 | 705 | 1.0 | -4.7 |
| Dredhëza | 1,677 | 1,487 | 1,439 | 2.1 | -3.2 |
| Qershia | 586 | 538 | 485 | 0.7 | -9.9 |
| Aronia | 666 | 692 | 656 | 1.0 | -5.2 |
| Boronica | 310 | 464 | 469 | 0.7 | 1.0 |
| Ftoi | 1,283 | 1,264 | 1,266 | 1.9 | 0.2 |
| Mushmolla | 222 | 219 | 213 | 0.3 | -2.6 |
| Pjeshka | 330 | 288 | 262 | 0.4 | -9.1 |
| Manaferra | 239 | 233 | 223 | 0.3 | -4.6 |
| Kajsia | 100 | 94 | 94 | 0.1 | 0.2 |
| Pemë të tjera | 101 | 97 | 90 | 0.1 | -7.2 |
| **Gjithsej prodhimi i pemëve** | **67,294** | **72,265** | **67,533** | **100.0** | **-6.5** |

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21)

Rendimenti i kulturave pemëtare ka shënuar ulje në vitin 2021 si rezultat i kushteve klimatike që kanë mbizotëruar, ku ulja në rendiment ka variuar nga 1%, tek kategoria pemë të tjera deri në 22% tek arra. Përveç arrës që shënoi rënie mbi 20%, kultura tek të cilat rënia e rendimentit ishte mbi 10% ishin: kumbulla, pjeshka, lajthia, mjedra, dardha dhe qershia ndërsa kulturat e tjera kishin rënie nën 10%.

**Tabela 3: Rendimenti i kulturave pemëtare 2019-2021, në tonë/ha**

| Kultura | 2019 | 2020 | 2021 | Ndryshimi 2021/2020 në % |
|---|---|---|---|---|
| Molla | 11.25 | 12.40 | 12.12 | -2.2 |
| Kumbulla | 6.08 | 5.97 | 5.09 | -14.8 |
| Mjedra | 4.40 | 4.01 | 3.51 | -12.5 |
| Arra | 2.29 | 2.00 | 1.56 | -22.0 |
| Dardha | 8.38 | 9.10 | 8.01 | -12.0 |
| Lajthia | 0.32 | 0.30 | 0.26 | -12.9 |
| Vishnja | 3.34 | 3.17 | 2.94 | -7.5 |
| Dredhëza | 7.14 | 6.30 | 6.04 | -4.1 |
| Qershia | 5.46 | 4.98 | 4.40 | -11.6 |
| Aronia | 7.55 | 7.08 | 6.69 | -5.5 |
| Boronica | 5.48 | 5.40 | 5.03 | -6.7 |
| Ftoi | 14.24 | 13.94 | 13.61 | -2.4 |
| Mushmolla | 4.36 | 4.27 | 4.00 | -6.3 |
| Pjeshka | 6.95 | 6.00 | 5.17 | -13.8 |
| Manaferra | 7.88 | 7.53 | 6.92 | -8.1 |
| Kajsia | 4.56 | 4.23 | 4.00 | -5.3 |
| Pemë të tjera | 3.24 | 3.03 | 3.00 | -1.0 |

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21)

## 1.2 Kulturat pemëtare më të kultivuara

Sa i përket shpërndarjes së kulturave pemëtare nuk ka ndryshim të theksuar në orientimin e kultivimit në 3 vitet e fundit. Nëse krahasojmë vitin 2021 me vitin 2020 nuk ka fare ndryshim në përqindjen e pjesëmarrjes së kulturave pemëtare, ndërsa krahasuar me vitin 2019 shihet se ka një ulje të pjesëmarrjes tek molla për 2 pikë përqindje, tek kumbulla dhe mjedra për nga 1 pikë përqindje, ndërsa është rritur përqindja e pjesëmarrjes tek arra për 3 pikë përqindje dhe tek të gjitha pemët e tjera të grupuara në kategorinë "të tjera" për 1 pikë përqindje.

**Figura 1: Pjesëmarrja e kulturave pemëtare në gjithsej sipërfaqen e kultivuar me pemë**




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), përpunuar nga DAESB - MBPZhR

### 1.2.1 Molla

Në vitin 2021 sipërfaqja e kultivuar me mollë ishte 3,083 ha apo 0.5% më e lartë sesa në vitin 2020, ndërsa prodhimi shënoi rënie për 1.8%, e kjo si rezultat i uljes së rendimentit për 2.2%. Rendimenti mesatar në periudhën '19-'21 ishte 11.9 tonë për hektar dhe sipërfaqja e kultivuar me mollë u rrit në vazhdimësi (2.1% në vitin 2020 dhe 0.5% në vitin 2021).

**Figura 2: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i mollës**




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), përpunuar nga DAESB - MBPZhR

### 1.2.2 Kumbulla

Sipërfaqja me kumbull në vitin 2021 ishte 2,210 ha, që në krahasim me vitin 2020 ishte për 0.4% më e lartë. Rendimenti mesatar në periudhën '19-'21 ishte 5.7 tonë për hektar, duke rezultuar me prodhimtari mesatare prej 12,380 tonë.

**Figura 3: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kumbullës**




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), përpunuar nga DAESB - MBPZhR

### 1.2.3 Mjedra

Sipërfaqja mesatare me mjedër në periudhën '19-'21 ishte 1,654 ha, dhe me një rendiment mesatar prej 4 tonë për hektar i cili shënoi rënie në këtë periudhë, gjithsej prodhimi gjithashtu rezultoi me rënie për 7.6% në vitin 2020 dhe 12.3% në vitin 2021.

**Figura 4: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i mjedrës**




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), përpunuar nga DAESB - MBPZhR

### 1.2.4 Arra

Sipërfaqja me arrë nga 886 ha sa ishte në vitin 2019, u rrit për 46.1% në vitin 2020 (për 409 ha), dhe për 4.4% në vitin 2021 (për 56 ha), duke arritur kështu në 1,352 ha. Rritja në prodhim në vitin 2020 ishte si rezultat i rritjes së sipërfaqes sepse rendimenti shënoi ulje për 0.29 tonë për hektar, ndërsa rënia në prodhim në vitin 2021 u shoqërua nga ulja e rendimentit përkundër asaj se sipërfaqja vazhdoi të rritet.

**Figura 5: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i arrës**




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), përpunuar nga DAESB - MBPZhR

### 1.2.5 Dardha

Sipërfaqja me dardhë në periudhën '19-'21 nuk ndryshoi shumë, ku në këtë periudhë ishte një rritje për nga 4 ha në të dy vitet pas vitit 2019. Në vitin 2020 kishte rritje të rendimentit të arrës e kjo rezultoi me një rritje të gjithsej prodhimit për 27.7%, i cili pastaj pasoi me ulje për 18.6% si rezultat i uljes së rendimentit të dardhës në vitin 2021 për 22.0%.

**Figura 6: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i dardhës**




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), përpunuar nga DAESB - MBPZhR

# 2 Tregtia për sektorin e pemëve

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura të dhënat e eksportit dhe importit për kodin doganor dyshifror 08 (Pemët dhe arroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit), ku është dhënë një pasqyrë e përgjithshme për këtë kod doganor. Nga të dhënat e mëposhtme shihet se sasia e eksportit për kodin 08 ka shënuar rritje në vitin 2020 për 16.5%, dhe rënie në vitin 2021 për 23.4%, e që ky trend nuk është përcjellë në mënyrë të njëjtë edhe tek vlera e eksportit, e cila ka shënuar rritje në vitin 2020 për 26.1%, dhe në vitin 2021 për 17.7%. Rritje e vlerës së eksportit përkundër rënies në sasinë e eksportuar në vitin 2021 është për shkak të rritjes së vlerës mesatare për njësi të eksportuar nga 2 €/kg, sa ishte në vitin 2020 në 3 €/kg në vitin 2021. Sasia e importuar në kuadër të kodit doganor 08 është rritur në vazhdimësi në periudhën '19-'21, e kjo është përcjell edhe me rritje të vazhdueshme të vlerës së importit.

**Tabela 4: Eksporti dhe importi për pemë (kodin doganor 08[2])**

| | | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| **Eksporti** | Vlera në '000 € | 7,675 | 9,681 | 11,391 |
| | Sasia në tonë | 4,247 | 4,947 | 3,789 |
| **Importi** | Vlera në '000 € | 36,464 | 39,185 | 43,365 |
| | Sasia në tonë | 84,472 | 98,833 | 103,713 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Pjesëmarrja e kodit doganor 08 në gjithsej eksportin e produkteve bujqësore (kodet doganore 01-24), është 12% në periudhën '19-'21, ndërsa tek importi kjo pjesëmarrje është më e ulët përkatësisht 5% në vitin 2019 dhe 2020 dhe 4% në vitin 2021.

**Figura 7: Pjesëmarrja e vlerës së importit dhe eksportit të pemëve (kodi doganor 08) në vlerën e importit dhe eksportit të produkteve bujqësore (kodet doganore 01-24)**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

[2] Në kodin doganor 08 përveç pemëve përfshihet edhe shalqini, pjepri dhe rrushi.

Duke qenë se vlera e importit të produkteve bujqësore në kuadër të kodit doganor 08 është më e madhe sesa vlera e produkteve të eksportuara, bilanci tregtar për kodin doganor 08 është negativ në vlerë prej rreth 32 mil. €. Edhe pse eksporti ka shënuar rritje të vazhdueshme në vlerë, rritja e vlerës se importit ka bërë që bilanci tregtar të vazhdoj të jetë negativ dhe vlera negative e tij ka vazhduar të thellohet.

**Figura 8: Eksporti, importi dhe bilanci tregtar për pemë (kodi doganor 08[3]), në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

## 2.1 Eksporti dhe importi i kulturave pemëtare

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur eksporti sipas kulturave pemëtare për periudhën '19-'21 në vlerë dhe sasi dhe janë përjashtuar nga të dhënat e paraqitura rrushi, pjepri dhe shalqiri, duke qenë se nuk janë pjesë e kësaj analize dhe pjepri dhe shalqiri trajtohen tek perimet dhe rrushi si sektor në vete.

Kulturat pemëtare më të eksportuara në vitin 2021 ishin: mjedra, manaferra, dredhëza, molla dhe qershia (këto 5 kultura përbëjnë 57% të gjithsej vlerës së eksportit), pasuar nga kulturat e tjera të paraqitura në tabelë me gjithsej pjesëmarrje nën 1%, dhe kategoria pemë të tjera me pjesëmarrje 42.6%.

Pesë kulturat më të eksportuar që kishin pjesëmarrje prej 57%, në gjithsej vlerën e eksportit në vitin 2021, në vitin 2020 kishin pjesëmarrje 67% dhe në vitin 2019 (62%), e që kjo pastaj kryesisht u reflektua me ndryshim në përqindjen e pjesëmarrjes te kategoria pemë të tjera.

[3] Në kodin doganor 08 përveç pemëve përfshihet edhe shalqini, pjepri dhe rrushi.

**Tabela 5: Eksporti i kulturave pemëtare**

| Kultura[4] | 2019 | | 2020 | | 2021 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Vlera në € | Sasia në kg | Vlera në € | Sasia në kg | Vlera në € | Sasia në kg |
| Mjedra | 1,856,512 | 1,123,340 | 3,746,061 | 1,648,994 | 3,107,883 | 855,009 |
| Manaferra | 1,894,124 | 1,061,144 | 1,364,173 | 639,171 | 2,282,552 | 635,952 |
| Dredhëza | 407,186 | 202,576 | 672,141 | 312,881 | 834,534 | 362,222 |
| Molla | 136,120 | 119,088 | 178,905 | 256,936 | 145,478 | 234,767 |
| Qershia | 38,228 | 34,472 | 45,367 | 124,383 | 6,498 | 6,454 |
| Kumbulla | 850 | 1,262 | 64,647 | 85,854 | 5,308 | 8,249 |
| Dardha | - | - | 1,657 | 1,981 | 2,643 | 1,790 |
| Pjeshka | 181 | 315 | - | - | 1,120 | 1,835 |
| Vishnja | - | - | 44,352 | 42,240 | 480 | 225 |
| Arra | 2,046 | 364 | - | - | 407 | 171 |
| Gështenja | - | - | 3,115 | 1,923 | 150 | 68 |
| Nektarina | - | - | - | - | 80 | 40 |
| Ftoi | 190 | 271 | 223 | 557 | - | - |
| Kajsia | 1,050 | 210 | - | - | - | - |
| Lajthia | 20 | 3 | - | - | - | - |
| Pemë të tjera[5] | 2,670,994 | 1,023,811 | 2,911,443 | 1,184,609 | 4,736,524 | 1,421,061 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur kulturat më të eksportuara në periudhën '19-'21 (mjedra, manaferra, dredhëza dhe molla), përqindja mesatare e pjesëmarrjes së të cilave për këtë periudhë është 62%, ndërsa përqindja mesatare e eksportit të pemëve tjera që nuk janë të paraqitura në figurë është 38%.

**Figura 9: Vlera e eksportit të kulturave pemëtare, në %**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

[4] Renditja e kulturave është bërë në bazë të vlerës së eksportit në vitin 2021.

[5] Në pemë të tjera hyjnë të gjitha pemët e tjera të paspecifikuara në (Tabela 5)

Prej 37.5 mil. € import të pemëve në vitin 2021, 65.6% apo 24.6 mil. € janë import i disa prej kulturave kryesore që nuk kultivohen në vendin tonë, si: banane, portokall, mandarinë, limon, hurma kivi, fik, ananas, avokado dhe grejpfrut.

Pjesëmarrje prej 24% apo vlerë të importit prej 9.0 mil. € kanë: molla, dardha, nektarina, dredhëza, arra, pjeshka dhe ftoi, ndërsa pjesa tjetër prej 3.9 mil. € apo 10.2% është import i kultura tjera.

Edhe në vitet paraprake ka qenë situatë e ngjashme sikur në vitin 2021 sa i përket importit të kulturave pemëtare, ku në mesin e 7 pemëve që kemi edhe prodhim vendor dhe janë importuar më së shumti në vitin 2021 janë: molla, dardha, nektarina, dredhëza, arra, pjeshka dhe ftoi. Kjo ndryshon vetëm për vitin 2019 ku në vend të ftoit si pemë me vlerë më të madhe të importit është kajsia.

**Tabela 6: Importi i kulturave pemëtare**

| Kultura[6] | 2019 | | 2020 | | 2021 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Vlera në € | Sasia në kg | Vlera në € | Sasia në kg | Vlera në € | Sasia në kg |
| Molla | 3,111,913 | 8,882,418 | 3,580,090 | 11,162,164 | 3,516,311 | 11,600,912 |
| Dardha | 1,335,800 | 1,950,740 | 1,292,093 | 1,942,344 | 1,914,212 | 3,091,521 |
| Nektarina | 1,157,418 | 2,470,987 | 888,330 | 2,136,437 | 799,353 | 1,697,100 |
| Dredhëza | 588,715 | 848,128 | 371,288 | 514,485 | 753,170 | 781,465 |
| Arra | 1,284,213 | 426,771 | 346,634 | 83,419 | 746,706 | 202,736 |
| Pjeshka | 942,055 | 2,332,912 | 751,121 | 2,248,644 | 687,016 | 1,860,497 |
| Ftoi | 368,459 | 570,085 | 498,162 | 707,201 | 601,409 | 856,892 |
| Kumbulla | 213,001 | 608,036 | 287,374 | 782,032 | 344,086 | 673,818 |
| Gështenja | 250,798 | 166,436 | 249,794 | 239,042 | 327,257 | 314,672 |
| Kajsia | 432,075 | 782,244 | 242,063 | 409,352 | 295,405 | 374,555 |
| Qershia | 225,061 | 355,237 | 199,202 | 393,616 | 218,215 | 370,106 |
| Manaferra | 538 | 1,073 | 115,006 | 67,364 | 158,507 | 90,965 |
| Mjedra | 1,122 | 646 | 49,929 | 21,463 | 149,503 | 42,032 |
| Vishnja | 90,109 | 77,031 | 70,657 | 57,522 | 133,456 | 118,554 |
| Lajthia | 57,790 | 6,920 | 45,527 | 6,234 | 122,498 | 17,666 |
| Pemë të tjera[7] | 21,414,820 | 44,309,484 | 25,217,750 | 52,688,576 | 26,774,008 | 52,134,670 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në figurën e mëposhtme janë të paraqitura kulturat pemëtare që kultivohen në Kosovë e që janë importuar më së shumti, por që vlera e importit të tyre është mesatarisht rreth 25% e gjithsej importit të pemëve, ndërsa 75% është përqindja mesatare e pjesëmarrjes së importit të pemëve tjera që nuk janë të paraqitura në figurë.

[6] Renditja e kulturave është bërë në bazë të vlerës së importit në vitin 2021.

[7] Në pemë të tjera hyjnë të gjitha pemët e tjera të paspecifikuara në (Tabela 6)

**Figura 10: Vlera e importit të kulturave pemëtare, në %**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.1 Eksporti dhe importi i mollës

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura detajet sa i përket eksportit dhe importit të mollës në periudhën '19-'21, ku shihet se sasia e eksportuar është shumë e vogël në krahasim me sasinë e importuar.

Në vitin 2021 bilanci tregtar për mollë është negativ në vlerë 3.3 mil. € dhe në raport me vitin 2020 ka ndryshim pozitiv për vetëm rreth 1%. Nga gjithsej sasia e eksportuar në periudhën '19-'21, përqindja mesatare e pjesëmarrjes së eksportit të mollës së tharë është 23.4% e që kjo përqindje ishte shumë e lartë në vitin 2019 (54.1%), ndërsa në vitet pasuese 2020 dhe 2021 ishte 9.7% dhe 6.4%.

**Tabela 7: Eksporti dhe importi i mollës**

| | | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Eksporti | Vlera në '000 € | 136 | 179 | 145 |
| | Sasia në tonë | 119 | 257 | 235 |
| | Vlera për njësi të mollës së freskët të eksportuar (€/kg) | 0.45 | 0.61 | 0.51 |
| | Vlera për njësi të mollës së tharë të eksportuar (€/kg) | 1.73 | 1.48 | 2.18 |
| Importi | Vlera në '000 € | 3,112 | 3,580 | 3,516 |
| | Sasia në tonë | 8,882 | 11,162 | 11,601 |
| | Vlera për njësi të mollës së freskët të importuar (€/kg) | 0.35 | 0.32 | 0.30 |
| | Vlera për njësi të mollës së tharë të importuar (€/kg) | 15.18 | 20.22 | 6.50 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

#### 2.1.1.1 Eksporti i mollës

Mollë është eksportuar në sasi jo shumë të madhe dhe që pjesa më e madhe ka qenë mollë e freskët, ndërsa si mollë e tharë mesatarisht në periudhën '19-'21 është eksportuar rreth ¼ e gjithsej sasisë. Vlera mesatare për njësi të mollës së freskët të eksportuar në periudhën '19-'21, ka qenë 0.53 €/kg, ndërsa molla e tharë është eksportuar me vlerë mesatare për njësi prej 1.79 €/kg. Në vitin 2020 ka pasuar një sasi më të madhe të mollës së eksportuar dhe duke qenë se edhe vlera për njësi të mollës së freskët ka qenë më e lartë (0.61 €/kg), kjo ka rezultuar edhe më vlerë më të lartë të eksportit përkundër asaj se vlera për njësi të mollës së tharë të eksportuar ka qenë më e ulët (1.48 €/kg), por sasia e saj e eksportuar ka qenë shumë më e vogël (9.7%).

**Figura 11: Eksporti i mollës 2019-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Eksport i mollës më së shumti realizohet në periudhën kur është koha e vjeljes së mollës, duke qenë se atëherë kemi prodhim vendor dhe jemi në gjendje edhe të eksportojmë sepse kapaciteti i ruajtjes është shumë i kufizuar, andaj fermerët shesin prodhimet e tyre ose në tregun vendor ose gjejnë mundësi për të plasuar produktin e tyre në tregun e jashtëm.

**Tabela 8: Eksporti i mollës sipas muajve, në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Shtetet në të cilat është realizuar eksporti i mollës në vitin 2021 janë: Gjermania (37%), Kroacia (33%), Shqipëria (13%), Maqedonia e Veriut (7%) dhe vendet e tjera me pjesëmarrje 10%, ndërsa në vitin 2020 në Gjemani është eksportuar 53% e mollës, në Shqipëri 22%, Suedi 8%, Kroaci 7% dhe pjesa tjetër prej 10% në vendet e tjera.

**Figura 12: Eksporti i mollës sipas shteteve**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.1.2 Importi i mollës

Sasia mesatare e mollës së importuar në periudhën '19-'21, ishte 10,548 tonë dhe kryesisht ishte import i mollës së freskët. Vlera mesatare për njësi të mollës së freskët të importuar ishte 0.32 €/kg, ndërsa vlera për njësi e importit të mollës së tharë ishte shumë e lartë, mesatarisht 14 €/kg dhe dalloi nga viti në vit varësisht shtetit prej nga është importuar.

**Figura 13: Importi i mollës 2019-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Për të plotësuar nevojat vendore për konsum, import i mollës realizohet më shumë në periudhën kur nuk ka prodhim vendor në dispozicion, kryesisht nga muaji dhjetor deri në muajin maj.

**Figura 14: Importi i mollës sipas muajve, në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Pjesa më e madhe e mollës në vitin 2021 është importuar nga Maqedonia e Veriut (54%), pasuar nga Polonia (19%), Greqia, Serbia dhe Italia me nga 8% secila dhe 3% nga vendet e tjera. Gjithashtu edhe në vitin 2020, pjesa më e madhe e importit të mollës është realizuar nga Maqedonia e Veriut dhe Polonia.

**Figura 15: Importi i mollës sipas shteteve**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.2 Eksporti dhe importi i kumbullës

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura detajet sa i përket eksportit dhe importit të kumbullës në periudhën '19-'21. Në krahasim me kulturat e tjera pemëtare kumbulla shënon vlera të ulëta të tregtisë me shtetet e tjera, duke qenë se prodhimi vendor plotëson nevojat për konsum në shkallë mjaft të lartë.

**Tabela 9: Eksporti dhe importi i kumbullës**

| | | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Eksporti | Vlera në '000 € | 1 | 65 | 5 |
| | Sasia në tonë | 1 | 86 | 8 |
| Importi | Vlera në '000 € | 213 | 287 | 344 |
| | Sasia në tonë | 608 | 782 | 674 |
| | Vlera për njësi të kumbullës së freskët të importuar (€/kg) | 0.33 | 0.31 | 0.39 |
| | Vlera për njësi të kumbullës së tharë të importuar (€/kg) | 4.65 | 4.09 | 3.49 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

#### 2.1.2.1 Eksporti i kumbullës

Eksporti i kumbullës është mjaft i ulët dhe në periudhën kohore '19-'21, është viti 2020 kur u eksportuar një sasi prej 86 tonë në vlerë prej 65 mijë €.

**Figura 16: Eksporti i kumbullës 2019-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Eksporti i kumbullës është realizuar kryesisht në muajin gusht dhe shtator, atëherë kur është edhe periudha e vjeljes së kumbullës.

**Figura 17: Eksporti i kumbullës sipas muajve, në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Vendet në të cilat është eksportuar kumbull në vitin 2021 janë Serbia dhe Mali i Zi, ndërsa në vitin 2020 vendet ku është eksportuar kumbull janë: Austria, Zvicra dhe Mali i Zi.

**Figura 18: Eksporti i kumbullës sipas shteteve**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.2.2 Importi i kumbullës

Në periudhën '19-'21, kumbulla e freskët është importuar me vlerë mesatare për njësi prej 0.34 €/kg, ndërsa kumbulla e tharë u importua me vlerë mesatare për njësi prej 4.08 €/kg. Sasia e importit ka qenë e ulët në krahasim me kulturat e tjera pemëtare.

**Figura 19: Importi i kumbullës 2019-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i mollës më së shumti realizohet në muajit korrik, gusht dhe shtator, kryesisht nga vendet e regjionit ku për shkak të faktorëve klimatik, periudha e pjekjes është më e hershme sesa ne vendin tonë. Gjithashtu është muaji shtator në të cilin muaj ka konsum më të madh edhe si produkt i freskët por bëhet edhe përpunimi i saj për ruajtje për afat me të gjatë kohor.

**Figura 20: Importi i kumbullës sipas muajve, në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i kumbullës kryesisht realizohet nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Turqia, dhe nuk ka dallime të madhe nga viti në vit në aspektin e vendeve prej nga importohet.

**Figura 21: Importi i kumbullës sipas shteteve**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.3 Eksporti dhe importi i mjedrës

Mjedra është kulturë pemëtare që ka bilanc tregtar pozitiv, pra sasia e eksportuar e mjedrës tejkalon sasinë e importuar e cila është tejet simbolike. Ka dallime të mëdha nga viti në vit në vlerën për njësi të eksportuar dhe kjo varet edhe nga disponueshmëria e prodhimit në vendet e tjera. Sa i përket eksportit në periudhën '19-'21, përqindja mesatare e pjesëmarrjes së mjedrës së freskët të eksportuar është 59%, ndërsa mjedra jo e freskët (mjedra, të paziera apo të ziera me avull ose në ujë, të ngrira, pa ëmbëltues), ka përqindje mesatare të pjesëmarrjes prej 41%.

**Tabela 10: Eksporti dhe importi i mjedrës**

| | | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Eksporti | Vlera në '000 € | 1,857 | 3,746 | 3,108 |
| | Sasia në tonë | 1,123 | 1,649 | 855 |
| | Vlera për njësi të mjedrës së freskët të eksportuar (€/kg) | 1.63 | 2.20 | 4.34 |
| | Vlera për njësi të mjedrës jo të freskët të eksportuar (€/kg) | 1.71 | 2.33 | 2.52 |
| Importi | Vlera në '000 € | 1 | 50 | 150 |
| | Sasia në tonë | 1 | 21 | 42 |
| | Vlera për njësi të mjedrës së freskët të importuar (€/kg) | 0.51 | 2.21 | 3.55 |
| | Vlera për njësi të mjedrës jo të freskët të importuar (€/kg) | 3.13 | 3.99 | 3.64 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.3.1 Eksporti i mjedrës

Sasia më e madhe e mjedrës së eksportuar në periudhën '19-'21, është në vitin 2020, kur u eksportuan 1,649 tonë në vlerë prej 3.75 mil. €. Vlera për njësi të mjedrës së eksportuar ishte më e larta në vitin 2021 (4.34 €/kg), për dallim nga dy vitet paraprake që kjo vlerë ishte 2.20 €/kg në vitin 2020 dhe 1.63 €/kg në vitin 2019. Mjedra jo e freskët eksportohet me vlerë më të ulët për njësi dhe mesatarja në periudhën '19-'21, ishte 2.19 €/kg.

**Figura 22: Eksporti i mjedrës 2019-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Sipas muajve eksport më i madh i mjedrës realizohet në periudhën gusht-tetor, ku muaji shtator është edhe koha kur realizohet sasia më e madhe e eksportit duke qenë se është edhe periudha e vjeljes së prodhimit vendor.

**Figura 23: Eksporti i mjedrës sipas muajve, në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Mjedër në vitin 2021 është eksportuar në Gjermani (32%), Serbi (28%), Turqi (15%), Austri (11%), Shqipëri (6%) dhe vende të tjera 8%. Në vitin 2020 gjithashtu janë shtetet e njëjta në të cilat është eksportuar me përjashtim të Austrisë.

**Figura 24: Eksporti i mjedrës sipas shteteve**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.3.2 Importi i mjedrës

Kosova importon mjedër në sasi tejet simbolike, kjo sasi në vitin 2021 ka qenë 42 tonë dhe mjedra e freskët është importuar me 3.55 €/kg, ndërsa ajo jo e freskët me nga 3.64 €/kg. Viti 2019 është vit kur është importuar vetëm 650 kg mjedër në vlerë rreth 1 mijë €.

**Figura 25: Importi i mjedrës 2019-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Import të mjedrës kryesisht ka pasur në vitin 2021 (muajin gusht dhe shtator) dhe 2020 (gusht), ndërsa në muajt e tjerë ose nuk ka pasur fare import ose në sasi shumë të vogël.

**Figura 26: Importi i mjedrës sipas muajve, në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në vitin 2021, importi i mjedrës është realizuar kryesisht nga Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut dhe sasi shumë e vogël nga Serbia dhe vendet e tjera, ndërsa në vitin 2020 rreth 90% e importit është nga Mali i Zi.

**Figura 27: Importi i mjedrës sipas shteteve**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.4 Eksporti dhe importi i arrës

Arra sikurse edhe kumbulla në krahasim me kulturat e tjera pemëtare shënon vlera të ulëta të tregtisë me shtetet e tjera, duke qenë se prodhimi vendor plotëson nevojat për konsum në shkallë mjaft të lartë. Në periudhën '19-'21, arra në lëvozhgë është importuar me vlerë mesatare për njësi prej 1.46 €/kg, ndërsa arra e qëruar me nga 5.13 €/kg.

**Tabela 11: Eksporti dhe importi i arrës**

| | | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Eksporti | Vlera në '000 € | 2.0 | - | 0.4 |
| | Sasia në tonë | 0.4 | - | 0.2 |
| | Vlera për njësi të arrës në lëvozhgë të eksportuar (€/kg) | | | 1.00 |
| | Vlera për njësi të arrës së qëruar të eksportuar (€/kg) | 5.62 | | 3.19 |
| Importi | Vlera në '000 € | 1,284 | 347 | 747 |
| | Sasia në tonë | 427 | 83 | 203 |
| | Vlera për njësi të arrës në lëvozhgë të importuar (€/kg) | 1.42 | 1.52 | 1.45 |
| | Vlera për njësi të arrës së qëruar të importuar (€/kg) | 4.60 | 5.10 | 5.68 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

#### 2.1.4.1 Eksporti i arrës

Në periudhën '19-'21, arra është eksportuar në sasi shumë të vogël. Në vitin 2020 nuk ka pasuar fare eksport të arrës, përderisa në vitin 2019 është eksportuar vetëm si e qëruar për dallim nga viti 2021 që ka eksport të arrës edhe si e qëruar edhe si e paqëruar.

**Figura 28: Eksporti i arrës 2019-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në vitin 2019, eksport të arrës ka pasur vetëm në muajin gusht ku është eksportuar vetëm si arrë e qëruar, ndërsa në vitin 2021 eksport të arrës ka pasur nga muaji shtator deri në muajin dhjetor.

**Figura 29: Eksporti i arrës sipas muajve, në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në vitin 2021, eksporti i arrës është realizuar në Austri, Kroaci, Mal të Zi dhe Gjermani ndërsa në vitin 2019 vetëm në Austri dhe Kroaci.

**Figura 30: Eksporti i arrës sipas shteteve**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.4.2 Importi i arrës

Arra importohet në sasi të vogël, ku në vitin 2021 sasia e importuar e arrës ishte 203 tonë dhe importi i arrës në lëvozhgë u bë me nga 1.45 €/kg, ndërsa i arrës së qëruar me nga 5.68 €/kg.

**Figura 31: Importi i arrës 2019-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në aspektin kohor importi i arrës dallon nga viti në vit, por në përgjithësi është më i ulët në periudhën gusht-tetor. Në vitin 2021 vlera e importit të arrës ishte më e lartë në muajin mars dhe qershor pasuar nga muajt dhjetor, shkurt dhe nëntor, ndërsa muajit e tjerë kanë vlerë më të ulët të importit.

**Figura 32: Importi i arrës sipas muajve, në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në periudhën '20-'21, rreth 70% e importit të arrës u realizua nga Ukraina ndërsa pjesa tjetër nga Bullgaria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rumania dhe vendet e tjera.

**Figura 33: Importi i arrës sipas shteteve**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.5 Eksporti dhe importi i dardhës

Dardha eksportohet në sasi mjaft të vogël, në vitin 2019 nuk kishte fare eksport të dardhës, ndërsa në vitin 2020 dhe 2021 u eksportuan nga rreth 2 tonë me dardhë. Për të plotësuar nevojat vendore për konsum dardha edhe importohet nga vendet e tjera. Në vitin 2021, sasia e importuar e dardhës në krahasim me dy vitet paraprake është më e madhe për rreth 60%. Në vitin 2021, prodhimi vendor i dardhës është më i ulët në krahasim me dy vitet paraprake. Vlera mesatare për njësi të dardhës së importuar në periudhën '19-'21, është 0.66 €/kg, dhe përveç dardhës së freskët që është tregtuar, një sasi shumë e vogël e dardhës së tharë është eksportuar në vitin 2021, ndërsa është importuar në vitin 2020.

**Tabela 12: Eksporti dhe importi i dardhës**

| | | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Eksporti | Vlera në '000 € | | 2 | 3 |
| | Sasia në tonë | | 2 | 2 |
| | Vlera për njësi të dardhës së freskët të eksportuar (€/kg) | | 0.84 | 1.37 |
| Importi | Vlera në '000 € | 1,336 | 1,292 | 1,914 |
| | Sasia në tonë | 1,951 | 1,942 | 3,092 |
| | Vlera për njësi të dardhës së freskët të importuar (€/kg) | 0.68 | 0.67 | 0.62 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.5.1 Eksporti i dardhës

Eksport të dardhës kishte në vitin 2020 dhe vitin 2021, ku vlera për njësi të eksportuar në vitin 2020 ishte 0.84 €/kg, ndërsa në vitin 2021 1.37 €/kg, kjo për shkak të asaj se në vitin 2021 kishte edhe eksport të dardhës për fermentim e që u eksportua me çmim më të lartë.

**Figura 34: Eksporti i dardhës 2020-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Eksport të dardhës varësisht muajit kishte kryesisht në periudhën korrik-nëntor, kur edhe u eksportua dardhë në sasi shumë të vogël por që më së shumti u eksportua në muajin tetor.

**Figura 35: Eksporti i dardhës sipas muajve, në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Eksporti i dardhës në vitin 2021 është realizuar në Mal të Zi, Kroaci dhe Zvicër, ndërsa në vitin 2020 vetëm në Austri dhe Kroaci.

**Figura 36: Eksporti i dardhës sipas shteteve**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 2.1.5.2 Importi i dardhës

Për plotësimin e nevojave vendore për konsum në vitin 2021, janë importuar 3,092 tonë me dardhë në vlerë prej 1.9 mil. €. Vlera për njësi të dardhës së importuar në vitin 2021 ishte 0.62 €/kg apo 7.5% me e ulët sesa në vitin 2020.

**Figura 37: Importi i dardhës 2019-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Duke qenë se me prodhim vendor Kosova nuk plotëson nevojat për konsum, dardhë importohet gjatë gjithë vitit, por që në kohën kur sasi më e madhe e prodhimit vendor është e pranishme në treg, importi është më i ulët (muajt gusht dhe shtator).

**Figura 38: Importi i dardhës sipas muajve, në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i dardhës në vitin 2021 është realizuar nga Turqia, pasuar nga Italia, Argjentina, Greqia dhe vendet e tjera me 10%, ndërsa në vitin 2020 përveç vendeve nga të cilat u importua dardhë në vitin 2021 është edhe Serbi nga e cila u importua 6% nga gjithsej sasia e importuar.

**Figura 39: Importi i dardhës sipas shteteve**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

# 3 Çmimet e kulturave pemëtare

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura çmimet për 5 kulturat pemëtare më të kultivuara në Kosovë, çmimet janë të paraqitura në nivel të fermës, në nivel të shitjes me shumicë dhe në nivel të shitjes me pakicë. Në vitin 2021, vërehet një rritje e çmimeve të kulturave pemëtare në të gjitha nivelet dhe për të gjitha këto 5 kultura.

**Tabela 13: Çmimet e kulturave pemëtare 2019-2021**

| | 2019 | 2020 | 2021 | Ndryshimi 2021/2020 (%) |
|---|---|---|---|---|
| **Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, €/kg** | | | | |
| Arrë | 2.16 | 2.06 | 2.13 | 3 |
| Dardhë | 0.81 | 0.72 | 0.91 | 26 |
| Kumbull | 0.51 | 0.71 | 0.81 | 14 |
| Mjedër | 1.77 | 1.73 | 3.50 | 102 |
| Mollë | 0.39 | 0.31 | 0.44 | 42 |
| **Çmimet mesatare vjetore të tregut me shumicë, €/kg** | | | | |
| Arrë | 2.33 | 2.38 | 2.71 | 14 |
| Dardhë | 0.96 | 1.20 | 1.32 | 10 |
| Kumbull | 0.59 | 0.69 | 1.09 | 58 |
| Mjedër | 2.17 | 2.07 | 4.00 | 93 |
| Mollë | 0.49 | 0.64 | 0.73 | 14 |
| **Çmimet mesatare vjetore të tregut me pakicë, €/kg** | | | | |
| Arrë | 2.61 | 2.56 | 2.96 | 16 |
| Dardhë | 1.13 | 1.35 | 1.45 | 7 |
| Kumbull | 0.75 | 0.79 | 1.48 | 87 |
| Mjedër | 2.44 | 2.26 | 4.25 | 88 |
| Mollë | 0.60 | 0.74 | 0.84 | 14 |

Burimi: DAESB – MBPZhR

## 3.1 Çmimet për kulturën e mollës

Çmimi mesatar i fermës për mollë në periudhën '19-'21 ishte 0.38 €/kg, ku vërehet rritje e çmimit në vitin 2021 për 41.9% në krahasim me vitin 2020. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 0.62 €/kg, apo 63% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 0.73 €/kg, apo 17% më i lartë sesa çmimi mesatar i shitjes me shumicë.

**Figura 40: Çmimet për mollë, 2019-2021**




Burimi: DAESB – MBPZhR

## 3.2 Çmimet për kulturën e kumbullës

Çmimi mesatar i fermës për kumbull për vitin 2021 është 0.81 €/kg, që në krahasim me 2 vitet paraprake është çmim më i lartë. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 0.79 €/kg, apo 17% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 1.01 €/kg, apo 27% më i lartë sesa çmimi mesatar i shitjes me shumicë.

**Figura 41: Çmimet për kumbull, 2019-2021**




Burimi: DAESB – MBPZhR

## 3.3 Çmimet për kulturën e mjedrës

Çmimi mesatar i fermës për mjedër në periudhën '19-'21 ishte 2.33 €/kg, ku vërehet rritje e çmimit në vitin 2021 për 102%, në krahasim me vitin 2020. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 2.75 €/kg, apo 18% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 2.98 €/kg, apo 9% më i lartë sesa çmimi mesatar i shitjes me shumicë.

**Figura 42: Çmimet për mjedër, 2019-2021**




Burimi: DAESB – MBPZhR

## 3.4 Çmimet për kulturën e arrës

Çmimi mesatar i fermës për arrë për vitin 2021 është 2.13 €/kg, që në krahasim me vitin paraprake është çmim më i lartë, ndërsa krahasuar me vitin 2019 është për 0.03 €/kg më i ulët. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 2.47 €/kg, apo 17% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 2.71 €/kg, apo 10% më i lartë sesa çmimi mesatar i shitjes me shumicë.

**Figura 43: Çmimet për arrë, 2019-2021**




Burimi: DAESB – MBPZhR

## 3.5 Çmimet për kulturën e dardhës

Çmimi mesatar i fermës për dardhë në periudhën '19-'21 ishte 0.81 €/kg, ku vërehet rritje e çmimit në vitin 2021 për 26%, në krahasim me vitin 2020. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 1.16 €/kg, apo 43% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 1.31 €/kg, apo 13% më i lartë sesa çmimi mesatar i shitjes me shumicë.

**Figura 44: Çmimet për dardhës, 2019-2021**




Burimi: DAESB – MBPZhR

# 4 Mbështetja direkte për sektorin e pemëve

Sektori i pemëtarisë mbështetet përmes Programit të Pagesave Direkte. Mbështetja për kulturat pemëtare kryesisht realizohet për hektar të kultivuar me përjashtim të mjedrës e cila mbështetet për kg. Gjithashtu për pemishtet që janë të kultivuara si organike fermerët përfitojnë pagesë më të madhe për njësi sesa për pemishtet që nuk janë organike. Sa i përket inputeve përmes pagesave direkte mbështetet prodhimtaria e fidanëve të pemëve drufrutore.

Duke marr parasysh se në vitin 2020 vendi ynë si edhe çdo vend tjetër u përball me pandeminë Covd-19, në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike është implementuar masa 4A – Dyfishimi i buxhetit për Programin e Pagesave Direkte vetëm për vitin 2020, ku në shtator të vitit 2020 Qeveria mori vendimin që për implementim të kësaj mase të dyfishohen vlerat e pagesave direkte (subvencioneve), për secilën kulturë/masë të paraparë në Programin e Pagesave Direkte për vitin 2020, krahasuar me vlerat e vitit 2019.

Në vitin 2021 janë mbështetur 4.57 ha me pemishte ekzistuese organike në vlerë prej gjithsej 2,056.50 €, apo 450 €/ha, ku subvencionimi prej 400 €/ha është subvencionimi bazë për pemishte ekzistuese, ndërsa 50 €/ha është subvencionimi shtesë për pemishte organike.

**Tabela 14: Pagesat direkte për sektorin e pemëve 2019-2021**

| | | 2019 | 2020 | 2020 (PRE) | 2021 |
|---|---|---|---|---|---|
| Pemishte ekzistuese | Numri i aplikuesve | 3,557 | 3,166 | 3,166 | 2,929 |
| | Numri i përfituesve | 3,488 | 3,034 | 3,034 | 2,774 |
| | Numri i ha të paguar | 4,142 | 4,757 | 4,757 | 4,536 |
| | Pagesa për ha | 400 | 400 | 400 | 400 |
| | Shuma totale e paguar | 1,656,812 | 1,902,868 | 1,902,868 | 1,814,448 |
| **Mjedër** | Numri i aplikuesve | 967 | 525 | 525 | 376 |
| | Numri i përfituesve | 594 | 386 | 386 | 320 |
| | Numri i kg të paguara | 898,547 | 1,055,337 | 1,055,337 | 864,717 |
| | Pagesa për kg | 0.08 | 0.12 | 0.04 | 0.12 |
| | Shuma totale e paguar | 71,883 | 126,640 | 42,213 | 103,766 |
| **Bujqësi organike – Pemishte ekzistuese** | Numri i aplikuesve | - | 1 | 1 | 1 |
| | Numri i përfituesve | - | 1 | 1 | 1 |
| | Numri i ha të paguar | - | 6.20 | 6.20 | 4.57 |
| | Pagesa për ha | - | 450 | 550 | 450 |
| | Shuma totale e paguar | - | 2,790 | 3,410 | 2,057 |
| **Fidanë të pemëve drufrutore** | Numri i aplikuesve | 12 | 11 | 11 | 14 |
| | Numri i përfituesve | 12 | 11 | 11 | 11 |
| | Numri i fidanëve të paguar | 297,300 | 322,609 | 322,609 | 274,700 |
| | Pagesa për fidan | 0.15/0.20 | 0.15/0.20 | 0.15/0.21 | 0.15/0.20 |
| | Shuma totale e paguar | 56,510 | 63,089 | 63,089 | 67,757 |

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike; Në vitin 2019 mbështetja për bujqësi organike nuk ka qenë e ndarë sipas kulturave andaj edhe nuk janë prezantuar të dhënat për pemishte organike.

Në periudhën 2019-2021, pjesëmarrja mesatare e pagesave direkte për sektorin e pemëtarisë (përfshirë pagesat për sipërfaqe, për prodhim të mjedrës, për sipërfaqe me pemishte organike dhe për fidanë të pemëve drufrutore), ishte 6.1%. Në këtë periudhë kohore pjesëmarrja më e lartë ishte në vitin 2021 (6.9%). Gjithsej pagesat për sektorin e pemëtarisë në vitin 2021 ishin 1.99 mil. €, ishte më e ulët për 5.1% në raport me pagesat e rregullta të vitit 2020, ndërsa në raport me vitin 2019 ishte me e lartë për 11.4%.

**Figura 45: Pjesëmarrja e kulturave pemëtarë në gjithsej pagesat direkte për sektorin e pemëtarisë[8]**




Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike; Në vitin 2019 mbështetja për bujqësi organike nuk ka qenë e ndarë sipas kulturave andaj edhe nuk janë prezantuar të dhënat për pemishte organike.

Në vitin 2021 nga gjithsej pagesat direkte për kultura pemëtare 30% janë për mollë, 28% për arrë, 15% për kumbull, 6% për lajthi dhe 21 % të shpërndara për kulturat e tjera. Shpërndarje pothuajse e njëjtë është edhe në vitin 2020, me dallim nga 1 deri në 4 pikë përqindje më pak apo më shumë varësisht kulturës.

**Figura 46: Shpërndarja e pagesave direkte sipas kulturave pemëtarë (%)**




Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

[8] Gjatë kulkulimit të pjesëmarrjes si total për sektorin e pemëtarisë është përdorur (shuma për pemishte ekzistuese+shuma për mjedër+bujqësi organike – pemishte ekzistuese+ Fidanë të pemëve drufrutore)

## 4.1 Pagesat direkte për mollë

Në vitin 2021 numri i aplikuesve për mbështetje direkte për mollë ishte 1,252 fermerë nga të cilët 95% përfituan, ndërsa 5% u refuzuan për mosplotësim kriteresh apo mungesë të dokumenteve. Numri i hektarëve të subvencionuar ishte 1,423 ha dhe gjithsej shuma e mbështetjes ishte 569 mijë €. Pagesa për njësi në periudhën '19-'21 nuk ndryshoi dhe ishte 400 €/ha.

**Tabela 15: Pagesa direkte për mollë, 2019-2021**

| | 2019 | 2020 | 2020 (PRE) | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Numri i aplikuesve | 1,365 | 1,387 | 1,387 | 1,252 |
| Numri i përfituesve | 1,348 | 1,384 | 1,384 | 1,189 |
| **Numri i ha të paguar** | **1,621** | **1,647** | **1,647** | **1,423** |
| Pagesa për ha | 400 | 400 | 400 | 400 |
| **Shuma totale e paguar** | **648,588** | **658,900** | **658,900** | **569,244** |

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Në vitin 2021 numri i aplikuesve ishte më i vogël në krahasim me vitet paraprake, por edhe përqindja e refuzimit ishte më e madhe sepse ishin kriteret në PPD që u ndryshuan në krahasim me vitet paraprake ku për të dëshmuar pronësinë e tokës së punuar e për të cilën është aplikuar për subvencionim u kërkua që të dëshmohet trashëgimia në rastet kur toka nuk ishte në emër të aplikuesit.

**Figura 47: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për mollë**




Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

## 4.2 Pagesat direkte për kumbull

Në periudhën '19-'21, numri mesatar i hektarëve të kumbullës së subvencionuar ishte 734 ha e të cilët u mbështetën me nga 400 €/ha. Numri mesatar i aplikuesve ishte 836, ndërsa përfituan mesatarisht 812 aplikues, apo 97% e aplikuesve. Edhe tek kumbulla ashtu si tek molla përqindja e refuzimit ishte më e lartë në vitin 2021 (6%), si rezultat i ashpërsimit të kritereve për të përfituar.

**Tabela 16: Pagesa direkte për kumbull, 2019-2021**

| | 2019 | 2020 | 2020 (PRE) | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Numri i aplikuesve | 822 | 875 | 875 | 811 |
| Numri i përfituesve | 804 | 869 | 869 | 764 |
| Numri i ha të paguar | 715 | 780 | 780 | 706 |
| Pagesa për ha | 400 | 400 | 400 | 400 |
| **Shuma totale e paguar** | **286,154** | **311,836** | **311,836** | **282,592** |

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Numri i hektarëve të subvencionuar në vitin 2021 ishte 706 ha, apo 9.4 % më i ulët sesa në vitin 2020, ndërsa krahasuar me vitin 2019 ishte për vetëm 1.2% më i ulët.

Gjithsej shuma e pagesave direkte për kumbull në vitin 2021 ishte për 9.4% më e ulët sesa pagesa e rregull për kumbull në vitin 2020, ndërsa për vetëm 1.2% më e ulët krahasuar me vitin 2019. Në vitin 2020 shuma e pagesave direkte për kumbull u dyfishuar si për çdo kulturë tjetër për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid 19.

**Figura 48: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për kumbull**




Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

## 4.3 Pagesat direkte për mjedër

Në vitin 2021, numri i aplikuesve për mbështetje direkte për mjedër ishte 376 fermerë nga të cilët 85% përfituan, ndërsa 15% u refuzuan për mosplotësim kriteresh apo mungesë të dokumenteve. Numri i kilogramëve të subvencionuar ishte 864,717 kg dhe gjithsej shuma e mbështetjes ishte 103.8 mijë €. Pagesa për njësi në periudhën '19-'21 ndryshoi nga 0.08 €/kg sa ishte në vitin 2019 në 0.12 €/kg në vitin 2020 dhe 2021. Në vitin 2020 në kuadër të PRE-së për mjedër u paguan edhe nga 0.04 €/kg si shtesë e pagesës së rregullt të planifikuar prej 0.12 €/kg.

**Tabela 17: Pagesa direkte për mjedër, 2019-2021**

| | 2019 | 2020 | 2020 (PRE) | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Numri i aplikuesve | 967 | 525 | 525 | 376 |
| Numri i përfituesve | 594 | 386 | 386 | 320 |
| Numri i kg të paguar | 898,547 | 1,055,337 | 1,055,337 | 864,717 |
| Pagesa për kg | 0.08 | 0.12 | 0.04 | 0.12 |
| **Shuma totale e paguar** | **71,883** | **126,640** | **42,213** | **103,766** |

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Duke qenë se numri i përfituesve në vitin 2021 ishte më i vogël, sasia e mjedrës së subvencionuar në vitin 2021 ishte më e vogël në krahasim me vitin 2020 për 18% dhe 4% më e vogël në krahasim me vitin 2019.

**Figura 49: Sasia e subvencionuar dhe shuma e paguar për mjedër**




Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

## 4.4 Pagesat direkte për arrë

Në vitin 2021 numri i aplikuesve për mbështetje direkte për arrë ishte 848 fermerë nga të cilët 95% përfituan, ndërsa 5% u refuzuan për mosplotësim kriteresh apo mungesë të dokumenteve. Numri i hektarëve të subvencionuar ishte 1,361 ha dhe gjithsej shuma e mbështetjes ishte 544.5 mijë €. Pagesa për njësi në periudhën '19-'21 nuk ndryshoi dhe ishte 400 €/ha.

**Tabela 18: Pagesa direkte për arrë, 2019-2021**

| | 2019 | 2020 | 2020 (PRE) | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Numri i aplikuesve | 556 | 723 | 723 | 848 |
| Numri i përfituesve | 551 | 721 | 721 | 808 |
| Numri i ha të paguar | 865 | 1,219 | 1,219 | 1,361* |
| Pagesa për ha | 400 | 400 | 400 | 400 |
| **Shuma totale e paguar** | **346,188** | **487,788** | **487,788** | **544,500** |

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Sqarim: *Sipërfaqja me arrë e subvencionuar është më e madhe sesa sipërfaqja totale me arrë e paraqitur në tabelën 1 për 9 ha sepse ASK i ka përdorur të dhënat e subvencioneve por janë pa përfshirë pagesat sipas vendimeve të komisionit të ankesave.

Sipërfaqja e arrës së subvencionuar në vitin 2021 ishte për 11.6% më e madhe sesa në vitin 2020, ndërsa në krahasim me vitin 2019 u rrit për 57.3%. Në vitin 2021 një përfitues mesatarisht u mbështet për 1.68 ha, ndërsa shuma mesatare e përfituar nga një përfitues ishte 673.89 €.

**Figura 50: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për arrë**




Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

## 4.5 Pagesat direkte për dardhë

Për kulturën e dardhës në periudhën '19-'21 ka numër shumë të vogël të fermerëve të refuzuar, 1 në vitin 2019, 7 në vitin 2021, ndërsa në vitin 2020 nuk ka asnjë fermerë aplikues për dardhë që është refuzuar. Pagesa ka qenë 400 €/ha dhe nuk ka ndryshuar gjatë këtyre viteve.

**Tabela 19: Pagesa direkte për dardhë, 2019-2021**

| | 2019 | 2020 | 2020 (PRE) | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Numri i aplikuesve | 133 | 154 | 154 | 162 |
| Numri i përfituesve | 132 | 154 | 154 | 155 |
| Numri i ha të paguar | 133 | 160 | 160 | 170 |
| Pagesa për ha | 400 | 400 | 400 | 400 |
| **Shuma totale e paguar** | **53,251** | **64,192** | **64,192** | **67,936** |

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Numri mesatar i hektarëve të dardhës së subvencionuar në periudhën '19-'21 ishte 154 ha, dhe më i larti ishte në vitin 2021 (170 ha). Në vitin 2021 një përfitues mesatarisht u mbështet për 1.10 ha, ndërsa shuma mesatare e përfituar nga një përfitues ishte 438.30 €.

**Figura 51: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për dardhë**




Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR; 2020 (PRE) - mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

# 5 Plotësimi i nevojave vendore dhe konsumi

Vendi ynë është importues neto i produkteve bujqësore, duke qenë se importi është më i madh sesa eksporti i këtyre produkteve. Nevoja për të importuar produkte nga vendet e tjera vjen nga ajo se Kosova nuk arrin të plotëson nevojat konsumuese të popullsisë me prodhim vendor.

## 5.1 Plotësimi i nevoja vendore me kultura pemëtare

Plotësimi i nevojave vendore për konsum me kultura pemëtare është në nivelin rreth 50%, e cila përqindje në periudhën '19-'21 ka variuar nga 49 deri në 53%. Pra, vendi ynë më prodhim vendor plotëson nevojat vendore të popullsisë për konsum rreth 50%, ndërsa pjesa tjetër plotësohet nga produktet e importuara. Në vitin 2021, prodhimi vendor i kulturave pemëtare ishte 67,533 tonë, u importuan 74,228 tonë, ndërsa u eksportuan 3,528 tonë duke rezultuar kështu me përqindje të plotësimit të nevojave vendore prej 49%.

**Figura 52: Furnizimi me kultura pemëtare, 2019-2021**




Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 5.1.1 Plotësimi i nevojave vendore për kulturat pemëtare më të kultivuara

Në vitin 2021 u prodhuan 37,381 tonë me mollë, u importuan 11,601 tonë, ndërsa eksporti ishte tejet simbolik me vetëm 235 tonë. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo përqindja e plotësimit të nevojave vendore për konsum të mollës me prodhim vendor ishte 77%, apo 1 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin 2020 dhe 2 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin 2019.

**Figura 53: Furnizimi me mollë, 2019-2021**




Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Kumbulla është kulturë pemëtare tek e cila shkalla e plotësimit të konsumit me prodhim vendor është rreth 95%, pra kjo kulturë pemëtare importohet shumë pak dhe përqindje mesatare e pjesëmarrjes së kumbullës së importuar në gjithsej përdorim është rreth 5%.

**Figura 54: Furnizimi me kumbull, 2019-2021**




Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Mjedra është kulturë pemëtare e cila plotëson tërësisht nevojat për konsum të popullsisë në Kosovë dhe gjithashtu edhe eksportohet duke rezultuar edhe me bilanc tregtar negativ. Shkalla mesatare e vetëmjaftueshmërisë për mjedër në periudhën '19-'21 është 122% që nënkupton tejkalim të nevojave vendore për konsum.

**Figura 55: Furnizimi me mjedër, 2019-2021**




Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Për plotësim të nevojave vendore për konsum kultura e arrës edhe importohet, përqindja mesatare e pjesëmarrjes së importit në gjithsej përdorimin vendor në periudhën '19-'21 ishte 10%, ndërsa pjesa tjetër prej 90% është mbuluar nga prodhimi vendor. Në rastin e arrës plotësimi i nevojave vendore për konsum është në nivel të kënaqshëm.

**Figura 56: Furnizimi me arrë, 2019-2021**




Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në vitin 2021 u prodhuan 4,953 tonë me dardhë, u importuan 3,092 tonë, ndërsa eksporti ishte tejet simbolik me vetëm 2 tonë. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo përqindja e plotësimit të nevojave vendore për konsum të dardhës me prodhim vendor ishte 62%, apo 12 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin 2020 dhe 10 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin 2019.

**Figura 57: Furnizimi me dardhë, 2019-2021**




Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

## 5.2 Konsumi për kokë banori

Në vitin 2021 konsumi i kulturave pemëtare vlerësohet të jetë rreth 78 kg në vit për kokë banori. Nga 5 kulturat pemëtare që kultivohen në Kosovë në sipërfaqe më të madhe, konsum më të lartë për kokë banori ka molla me 27 kg në vit, pasuar nga kumbulla (7 kg), dardha (5 kg), mjedra (3 kg) dhe arra (1 kg).

Konsumi i kultura të tjera pemëtare të cilat konsumohen në masë të madhe e që nuk kultivohen në Kosovë si: banane, portokall, mandarinë, limon, hurma, kivi, fik, ananas, avokado dhe grejpfrut është 29 kg në vit për kokë banori. Nga 29 kg të konsumi për këto kultura, konsum i bananes është 12 kg, mandarina 7 kg, portokaj 4 kg, limon 3 kg dhe 3 kg janë gjithsej për hurma, kivi, fik, ananas, avokado dhe grejpfrut.

**Figura 58: Konsumi i pemëve për kokë banori, 2019-2021**




Burimi: ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore ('19,'20,'21), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

## Konkluzionet

Nga të gjitha kulturat bimore të kultivuara në Kosovë, vlera e prodhimtarisë së pemëve paraqet rreth 16% të gjithsej vlerës së kulturave bimore. Kulturat pemëtare që kultivohen në sipërfaqe më të madhe në Kosovë janë: molla, kumbulla, mjedra, arra dhe dardha. Këto kultura përbëjnë 86% të gjithsej sipërfaqes me pemë.

Për të plotësuar nevojat konsumuese Kosova vazhdon të importon pemë nga vendet e tjera, ku nga kulturat që kultivohen në Kosovë pemët më të importuara janë: molla, dardha, nektarina, dredhëza, arra, pjeshka dhe ftoi, e gjithashtu në sasi të madhe importohen edhe kultura që nuk kultivohen në vendin tonë si: banane, portokall, mandarinë, limon, hurma kivi, fik, ananas, avokado dhe grejpfrut. Përveç se importon, Kosova gjithashtu eksporton kultura pemëtare në vendet tjera, por që sasia e eksportuar është dukshëm më e vogël sesa ajo e importuar në shumicën e rasteve.

Kulturat pemëtare më të eksportuara janë: mjedra, manaferra, dredhëza, molla dhe qershia. Eksport të kulturave pemëtare kryesisht ka në periudhën e vjeljes, duke qenë se vendi ynë ka kapacitete të kufizuara të ruajtjes dhe një pjesë shumë e madhe e prodhimit shitet ose eksportohen menjëherë pas vjeljes. Si rezultat i mungesës se kapaciteteve të ruajtjes për periudhë më të gjatë kohore, importi është kryesisht më i lartë në periudhën kur nuk është koha e vjeljes së kulturave pemëtare dhe me i ulët kur në dispozicion është prodhimi vendor.

Viti 2021, sikurse tek shumica e produkteve bujqësore edhe tek pemët u karakterizua me ngritje të çmimeve, e që kjo ngritje u reflektua duke filluar nga çmimet në nivel ferme e deri tek çmimet e shitjes me pakicë. Mbështetja e vazhdueshme për sektorin e pemëve si përmes pagesave direkte/subvencioneve (që ndikojnë në uljen e kostos së prodhimit), ashtu edhe përmes granteve (të cilat mundësojnë lehtësi në investime), ka ndikuar që sipërfaqet me pemë të rriten në vazhdimësi dhe mbështetja duhet të vazhdoj në mënyrë që të kemi më shumë prodhim vendor dhe të mos jemi të varur nga prodhimi i vendeve tjera, dhe në këtë mënyrë edhe të ndikohet në uljen e vlerës negative të bilancit tregtar. Kjo mund të arrihet jo vetëm me ngritje të sipërfaqeve të reja dhe rritje të prodhimit por duhet të bëhen investime dhe mbështetje në të gjitha nivelet e zingjirit të furnizimit që fermerët të jenë në gjendje edhe ta ruajnë prodhimin e tyre për kohë më të gjatë dhe të jenë të pranishëm në treg gjatë tërë vitit. Por edhe të zgjerohet aktiviteti i tyre dhe të bëjnë edhe përpunimin e kulturave pemëtare dhe të krijojnë vlerë të shtuar për prodhimin e tyre.

Duke marrë parasysh që kulturat kryesore pemëtare që aktualisht kultivohen në Kosovë janë: molla, kumbulla, mjedra, dredhëza dhe arra, për të arritur nivelin e kënaqshëm të prodhimit në mënyrë që të zëvendësohet sasia e importuar, fillimisht duhet të rriten sipërfaqet me këto kultura pemëtare për rreth 1,620 ha dhe të kenë prodhim të paktën sa është rendimenti mesatar aktualisht, por edhe të investohet dhe të rriten kapacitet në ruajtje dhe përpunim.

# Shtojca

**Tabela 20: Lista e kodeve doganore të përfshira në analizë tek kapitulli i tregtisë**

| Kultura | Kodi doganor 8 shifror | Përshkrimi |
|---|---|---|
| **Molla** | 08081010 | Mollë të freskëta për fermentim, në shumicë, nga 16 shtatori deri më 15 dhjetor |
| | 08081080 | Mollë të freskëta (përveç mollëve për fermentim, në shumicë, nga 16 shtatori deri në 15 dhjetor) |
| | 08133000 | Mollë të thara |
| **Kumbulla** | 08094005 | Kumbulla të freskëta |
| | 08132000 | Kumbulla të thara |
| **Mjedra** | 08102010 | Mjedra të freskëta |
| | 08112031 | Mjedra, të paziera apo të ziera me avull ose në ujë, të ngrira, pa ëmbëltues |
| **Arra** | 08023100 | Arra, të freskëta apo të thara, në lëvozhgë |
| | 08023200 | Arra, të freskëta apo të thara, të qëruara |
| **Dardha** | 08083010 | Dardha të freskëta për fermentim, në shumicë, nga 1 gushti deri më 31 dhjetor |
| | 08083090 | Dardha të freskëta (përveç atyre për fermentim, në shumicë, nga 1 gushti deri në 31 dhjetor) |
| | 08134030 | Dardha të thara |
| **Dredhëz** | 08101000 | Dredhëza të freskëta |
| | 08111011 | Dredhëza, të paziera apo të ziera me avull ose në ujë, të ëmbëlsuara, me përmbajtje sheqeri > 13%, të ngrira |
| | 08111019 | Dredhëza, të paziera apo të ziera me avull ose në ujë, të ëmbëlsuara, me përmbajtje sheqeri <= 13%, të ngrira |
| | 08111090 | Dredhëza, të paziera apo të ziera me avull ose në ujë, pa ëmbëltues, të ngrira |
| **Ftoni** | 08084000 | Ftonj të freskët |
| **Gështenjë** | 08024100 | Gështenja "Castanea spp." të freskëta apo të thara, në lëvozhgë |
| | 08024200 | Gështenja "Castanea spp." të freskëta apo të thara, të qëruara |
| **Kajsi** | 08091000 | Kajsi të freskëta |
| | 08131000 | Kajsi të thara |
| **Lajthi** | 08022100 | Lajthi "Corylus spp." të freskëta apo të thara, në lëvozhgë |
| | 08022200 | Lajthi "Corylus spp." të freskëta apo të thara, të qëruara |
| **Manaferrë** | 08102090 | Manaferra |
| | 08112059 | Manaferra dhe mana, të paziera apo të ziera me avull ose në ujë, të ngrira, pa ëmbëltues |
| **Nektarinë** | 08093010 | Nektarina të freskëta |
| **Pjeshkë** | 08093090 | Pjeshkë të freskëta (përveç nektarinave) |
| | 08134010 | Pjeshkë të thara, përfshirë nektarinat |
| **Qershi** | 08092900 | Qershi të freskëta (përveç vishnjave) |
| | 08119080 | Qershi, qofshin të ziera apo jo, me ujë apo avull, të ngrira, pa përmbajtje të sheqerit ose lëndëve tjera ëmbëltuese (përveç vishnjave "Prunus cerasus") |
| | 08121000 | Qershi, të konservuara përkohësisht, p.sh. me gaz dyoksidi të sulfurit, në shëllirë, në ujë sulfuror apo në solucione të tjera konservuese, por të papërshtatshme në atë gjendje për konsum të menjëhershëm |
| **Vishnje** | 08119075 | Vishnje "Prunus cerasus", qofshin të ziera apo jo, me ujë apo avull, të ngrira, pa përmbajtje të sheqerit ose lëndëve tjera ëmbëltuese |
| | 08092100 | Vishnje të freskëta "Prunus cerasus" |

Burimi: Dogana e Kosovës;

*Sqarim: Të dhënat e tregtisë për të gjithë kodet e tjera doganore 8 shifrore të pemëve në kuadër të kodit doganor dyshifror 08 e që nuk janë specifikuar në tabelën e mësipërme janë të grumbulluara në kategorinë "Të tjera" tek (Tabela 5) dhe (Tabela 6).